



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.41/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes së flamujve në shtylla elektrike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

### **VE N D I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë, ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

### **A r s y e t i m**

Me datën 22.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës, me të cilën pretendon se me datë 22.09.2017 në rrugën “Lidhja e Prizrenit” në Lipjan, monitoruesi i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla të ndriçimit publik ishin vendosur flamuj partiak të subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK). Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë të datës 23.09.2017, thekson se vendosja e flamujve përgjatë rrugëve në shtyllat elektrike të cilat janë të përshtatura ekskluzivisht për vendosjen e flamujve në solemnitete të ndryshme por edhe në fushata të këtilla zgjedhore, në asnjë rast nuk mund të përbëjë shkelje të dispozitave të ligjit apo të rregullave që parashohin këtë segment të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se flamujt e subjektit politik LDK janë të vendosur në shtylla elektrike, janë të qëndrueshme mirëpo paneli ka vlerësuar se vendosja e flamujve lëndor janë të vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e të njëjtëve, ashtu siç vërtetohet nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme përshkrimet në ankesë së është Thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik LDK. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nënin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr.41/2017 më datë 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit  
Gyltene Sylejmani**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***